



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1935/1 Prot.

Tiranë, më 07.08 .2023

V E N D I M

Nr. 25 datë 07.08 2023

“PËR  
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E  
ANALITIKE TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së neni 43, gërma II), në Vendimin e Senatit nr. 06, datë 27.01.2023 “Pë miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.07, datë 01.02.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023”, në shkresën e e MAS me nr 720/1 prot datë 04.07.2023 “Njoftim për rregjistrim dhe numrin e rregjistrimit për Titull akademik”Profesor i Asociuar”, me nr. 721/1 datë 04.07.2023 klasifikimit të pagës për vitin 2023”, me nr 722/1 prot datë 04.07.2023 “Njoftim për rregjistrim dhe numrin e rregjistrimit për Titull akademik”Profesor i Asociuar”, me nr 723/1 prot datë 04.07.2023 “Njoftim për rregjistrim dhe numrin e rregjistrimit për Titull akademik”Profesor i Asociuar”, si dhe shkresën me nr 724/1 prot datë 04.07.2023 “Njoftim për rregjistrim dhe numrin e rregjistrimit për Titull akademik”Profesor i Asociuar” në Vendimin e Rektoratit nr.75 datë 20.07.2023 ,Vendimin e Senatit Akademik nr. 87 datë 21.07.2023 “Për disa ndryshime në strukturën organizative e analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës” Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 07. 08. 2023,

V E N D O S I :

1. Miratimin dhe ndryshimin e strukturës organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si më poshtë:
  - **Z. Genti Petraq Pano**, Zv/Dekan në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit, me gradë shkencore “Doktor” kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 29.05.2023 e në vazhdim.
  - **Znj. Oltiana Mihal Petri**, Drejtuese e Departamentit të Shkencave Biomjekësore dhe Humane, FSHR, me gradë shkencore “Doktor” kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 29.05.2023 e në vazhdim.

- **Znj. Genta Astrit Nallbani**, me gradë shkencore “Doktor” pranë Departamentit të Kineziologjisë, FSHR, kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 29.05.2023 e në vazhdim.
  - **Znj. Rigerta Ismail Selenica**, me gradë shkencore “Doktor” pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, FSHL, kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 01.06.2023 e në vazhdim.
  - **Znj. Najada Arian Quka**, me gradë shkencore “Doktor” pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, FSHL, kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 01.06.2023 e në vazhdim.
2. Efektet financiare shtrihen nga data e përfitimit të titullit akademik dhe në zbatim të VKM me nr.243, datë 20.04.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Lidhja nr.1.
  3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, Njësitë kryesore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
  4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur COBANI**

